



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
T I R A N Ë

V E N D I M

Nr. 79, datë 27.12.2007

**“PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 53
DT.29.10.2007“PËR DISA NDRYSHIME NË NIVELIN E PAGAVE TË PUNONJËSVE
TË BASHKISË SË TIRANËS NË MBËSHTETJE TË V.K.M. NR. 434, DT.13.07.2007
“PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 551, DATË 07.11.2002 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KLASIFIKIMIN E FUNKSIONEVE DHE GRUPIMIN E NJËSIVE TË
QEVERISJES VENDORE, PËR EFEKT PAGE, E PËR CAKTIMIN E KUFIJVE TË
PAGAVE TË PUNONJËSVE TË ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE”, TË
NDRYSHUAR”**

Bazuar në Ligjin Nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 32/ç, të Ligjit Nr.8487, datë 13.05.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të Ligjit Nr.8935, datë 12.09.2002 “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 8487, datë 13.05.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, neni 6, gërma “a”, gërma “b” dhe gërma “c”, të Ligjit Nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.434, datë 13.07.2007 “Për disa ndryshime në Vendimin Nr.551, datë 7.11.2002 të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page, e për caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.52, datë 29.10.2007 “Mbi riorganizimin e strukturës organizative të Aparatit të Bashkisë së Tiranës, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I

1. Të miratojë nivelin e pagës për Sekretarin e Përgjithshëm (Administrator i Përgjithshëm) në Bashkinë e Tiranës sipas lidhjes Nr.1/1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sokol DERVISHAJ

K R Y E T A R I

Lidhja Nr. 1/1 – Niveli i pagës për Sekretarin e Përgjithshëm (Administrator) në Bashkinë e Tiranës

E M Ë R T I M I	Klasa	Grupi	Paga e grupit	Vjetërsia	Shtesa për pozicion
Sekretar i Përgjithshëm (Administratori I Përgjithshëm)	I	b	10050	2%	110 900

